



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 12 nëntor 2015

Numri i lëndës: 2014-02

Milica Radunovic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 12 nëntor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar me 3 shkurt 2014.

II. FAKTET

2. Ankuesja ishte punësuar nga ndërmarrja shoqërore (NSH) në Pejë nga data 17 nëntor 1976 deri në qershor të vitit 1999, kur ajo ishte detyruar të largohej nga Kosova gjatë konfliktit për shkaqe sigurie.

3. Ankuesja pohon se marrëdhënia e saj e punës me NSH-në asnjëherë nuk ishte ndërprerë. Ankuesja kishte paraqitur një kërkesë për pagesën e pagave të papaguara në shumën prej 1,650 Euro atëherë kur mësoj për likuidimin e NSH-së. Kjo kërkesë ishte paraqitur në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) në Beograd me 10 gusht 2006.
4. Më 8 maj 2013, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka nxjerrë një vendim, ku e hedh poshtë kërkesën e ankueses si të pavlefshme, pasi ankuesja nuk kishte përfillur afatin e zbatueshëm kohor.
5. Më 11 qershor 2013, ankuesja ka parashtruar ankesë kundër këtij vendimi në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme (DhPGJS). Së bashku me ankesën, ankuesja ka paraqitur një kërkesë për t'u liruar nga pagesa e përkthimit të parashtrësive në gjuhën angleze, si dhe për t'u liruar nga pagesa e taksave gjyqësore. Ankuesja arsyetoi kërkesën e saj për përjashtimin e taksave me faktin se ajo ishte person i zhvendosur brenda vendit (PZHBV) në një situatë të vështirë financiare dhe se pagesa e këtyre shpenzimeve do ta rrezikojë ekzistencën e familjes së saj. Kërkesa e saj ishte shoqëruar me kopjen e kartës së saj të regjistrimit të PZHBV-së dhe çekun e pensionit.
6. Më 2 tetor 2013, ankuesja ka marrë një kërkesë nga DhPGJS-ja për ta dorëzuar përkthimin e kërkesës së saj në gjuhën angleze në pajtim me nenin 25.8 të shtojcës së Ligjit nr. 04/I-033 i DhPGJS-së.
7. Më 16 tetor 2013, ankuesja ka parashtruar një ankesë kundër urdhrit të DhPGJS-së, duke argumentuar se DhPGJS-ja është e obliguar që së pari të vendos mbi kërkesën e ankueses për përjashtimin e shpenzimeve të përkthimit dhe shpenzimeve gjyqësore, para se të caktohet dhe mbahet seanca gjyqësore në pajtim me nenin 387.1 dhe 468 par. 5 të Ligjit mbi Procedurën Civile.
8. Më 17 dhjetor 2013, gjyqtari i vetëm i DhPGJS-ja i EULEX-it ka refuzuar kërkesën e ankueses për ndihmë juridike. Ankuesja ka pretenduar se arsyetimi i këtij vendimi ishte i paqartë, nuk përmbante fakte që ishin të përcaktuara apo ndonjë fakt që ishte konsideruar i rëndësishëm dhe vendimtar për vendimin.
9. Në rastin konkret, pagesa e tarifës apo shpenzimit për përkthim nuk është vënë si kusht paraprak për nisjen e procedurave pranë DhPGJS-së dhe kërkesa në rastin konkret ka rezultuar vetëm me vonesë. Vetë lënda është proceduar dhe vendimi pritet të merret.

III. ANKESAT

10. Ankuesja pohon shkeljet e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (Deklaratës):
 - Neni 6 i Konventës dhe neni 10 i Deklaratës: e drejta për gjykim të drejtë, në mënyrë të veçantë e drejta për qasje në gjykatë (tarifat

tepër ta larta gjyqësore dhe shpenzimet për përkthim) dhe e drejta për vendim të arsyeshëm (vendimi që mos të pranohet përjashtimi nga taksat gjyqësore dhe shpenzimet e përkthimit nuk ofron asnjë arsytim);

- Neni 13 i Konventës dhe neni 32 i Deklaratës: mungesa e zgjidhjes efektive (nuk ekziston mjeti për ankesë ndaj vendimit të mësipërm);
- Neni 14 i Konventës dhe neni 2 i Deklaratës: e drejta për barazi para ligjit dhe mos diskriminim (ankuesja pohon se ka pasur diskriminim mbi baza etnike).

IV. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

SHTOJCA E LIGJIT Nr.04/L-033 E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET E LIDHURA ME AGJENSINË PËR PRIVATIZIM

RREGULLAT E PROCEDURËS SË DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET E LIDHURA ME AGJENSINË PËR PRIVATIZIM

Neni 25 Parashtrimi i lutjeve

.....

8. Lutjet dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten ose në gjuhën shqipe ose në gjuhën serbe dhe duhet të shoqërohen nga një përkthim në gjuhën angleze. Shpenzimet e përkthimit i heq pala që dorëzon atë lutje dhe ato dokumente.

9. Një person fizik mund t'i paraqesë kërkesë Kryesuesit të Kolegjit për ndihmë rreth përkthimit në gjuhën angleze të lutjeve dhe dokumenteve përcjellëse. Kjo kërkesë duhet të dorëzohet bashkë me parashtresat dhe duhet të përfshijë një pasqyrë financiare të mjeteve të palës dhe çfarëdo dëshmie mbështetëse që pala dëshiron që Kryesuesi të marrë parasysh.

10. Gjyqtari kryesues mund të vendosë që përkthimi i lutjeve dhe i dokumenteve përcjellëse që kërkohen sipas paragrafi 8 i këtij neni të bëhet me shpenzimet e Dhomës së Posaçme, nëse ai apo ajo mendon se ky vendim është i arsyeshëm, duke pasur parasysh mjetet financiare të personit fizik. Nëse Kryesuesi i Kolegjit refuzon një kërkesë të tillë, ai duhet ta njoftojë palën me vendim me shkrim dhe të urdhërojë atë person që t'i sigurojë përkthimet në gjuhën angleze me shpenzimet e tij brenda afatit që përcaktohet në vendim. Nëse përkthimet nuk sigurohen brenda këtij afati, Dhoma e Posaçme urdhëron përkthimin e dokumenteve dhe shpenzimet ia ngarkon personit në fjalë.

11. Më 29 mars 2014, Ligji i mësipërm është ndryshuar si vijim:

Ligji Nr. 04/L-246PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-033 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME AGJENSINË E PRIVATIZIMIT TË KOSOVËS

Neni 2

1. Neni 25 i Shtojcës së ligjit bazik, paragrafi 8 riformulohet me tekstin si në vijim:

8. Të gjitha kërkesat dhe dokumentet përcjellëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, kurse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të sigurojë, me propozimin dhe burimet e saj, përkthimin e tyre në gjuhën angleze.

2. Neni 25 i Shtojcës së ligjit bazik, paragrafët 9 dhe 10 fshihen në tërësi.

Neni 67

Shpenzimet

1. Në Aktvendimin apo Aktgjykimin e tij lidhur me ankesën, Kolegji i Apelit merr një vendim lidhur me shpenzimet procedurale për shkallën e parë dhe atë të apelit. Dispozitat e neneve 56 dhe 57 të kësaj shtojce zbatohen *mutatis mutandis*.

2. Në vendimin e tij për shpenzimet, Kolegji i Apelit llogarit ndarazi shpenzimet për procedurat për shkallën e parë dhe atë të apelit.

V. Vlerësimi i Panelit

12. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) që përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
13. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do t'i pranoj ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të punës.
14. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv i referohet çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me drejtësinë, policinë dhe doganat.
15. Paneli konstaton se ankesa e ankueses ka të bëjë me qasjen e saj në procedurat pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

16. Paneli ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se sipas rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies së OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, në parim Paneli nuk ka juridiksion mbi aspektet administrative e as juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka juridiksion mbi aspektet administrative e as juridike të punës së gjykatave të Kosovës, në mesin e tyre në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të DhVGjS-së, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih në mesin e shumë autoriteteve të tjera, E kundër EULEX-it, 2012-17, 30 gusht 2013, par. 23; Fahri Rexhepi kundër EULEX-it, nr. 2014-19, 10 nëntor 2014, par. 12; Gani Zeka kundër EULEX-it, 2013-15, 4 shkurt 2014, par. 13).
17. Prandaj, në parim Paneli nuk mund të shqyrtoj vendimet e gjyqtarëve të EULEX-it si të tilla. Paneli tashmë ka konstatuar se megjithatë në rrethana të caktuara juridiksioni i Panelit do të mbuloj vendimet dhe aktet e autoriteteve gjyqësore si të tilla, posaçërisht aty ku akuzat e besueshme për shkelje të të drejtave të njeriut që i ngarkohen gjyqtarëve të EULEX-it nuk janë adresuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore në procedurën e ankimit (Tomë Krasniqi kundër EULEX, nr. 2014-04, 27 maj 2014, par. 15).
18. Paneli përkujton se e drejta për qasje në gjykatë, gjegjësisht e drejta për nisjen e procedurave në gjykatë në parim është e garantuar me nenin 6 të Konventës (shih midis shumë autoriteteve të tjera Tolstoi Miloslavsky kundër MB-së, Seria A, nr. 323, aktgjykim i datës 13 korrik 1995. par. 59 Golder kundër MB-së, 21 shkurt 1975, paragrafët 34-36, Seria A nr. 18; Z. dhe të Tjerët kundër MB-së [GC], nr. 29392/95, paragrafët 91-93, KEDNj-së 2001-V; dhe Kreuz kundër Polonisë, nr. 28249/95, paragrafi 52, KEDNj-së 2001). Personi nuk mund të përfitoj nga garancitë e mëtejme të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 6, përkatësisht në procedura gjyqësore të drejta, publike dhe të shpejta, nëse procedurat e tilla në rend të parë nuk janë të iniciuara. Dhe në çështjet civile vështirë se mund të paramendohet sundimi i ligjit nëse nuk ka mundësi për të pasur qasje në gjykata. Edhe pse e drejta e qasjes në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve në formë të rregullimit me ligj, ata duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe duhet të jetë një marrëdhënie e arsyeshme në mënyrë proporcionale midis tyre dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (Tolstoy Miloslavsky kundër MB-së, Seria A, nr. 323, i cituar më lartë).
19. Kërkesa për të kryer pagesën e taksave në gjykatat civile nuk mund të konsiderohet si kufizim i së drejtës së qasjes në gjykatë që në vetvete është e papajtueshme me nenin 6 § 1 të Konventës (shih Stankov kundër Bullgarisë, nr. 68490/01, par. 52, 12 korrik). Kjo në masë të madhe varet nga shuma e taksave që është vlerësuar në bazë të rrethanave të veçanta të një lënde të caktuar, duke përfshirë mundësinë e aplikantit për t'i paguar ato dhe fazën e procedurave në të cilën ky kufizim është vendosur, të cilat janë të rëndësishme në përcaktimin nëse personi ka gëzuar apo jo të drejtën e tij/saj në qasje (shih GjEDNj-në, Kreuz kundër Polonisë, cituar më lartë, paragrafi 60,

GjEDNj 2001-VI; Harrison McKee kundër Hungarinë, nr. 22840/07, paragrafi 29, 3 qershor 2014).

Paneli ka vënë re se kërkesa për të siguruar përkthimet e dokumenteve përkatëse në gjuhën angleze mund të përbëj barrë të rëndë për disa ankues, siç është rasti i ankueses, e cila është PZhBV e papunë dhe e cila jeton me një ndihmë sociale modeste. Kjo mund të dëmtojë mundësinë e paditësit për të kërkuar dhe për të realizuar një mjet korrigjues për të cilat ai përndryshe do të ketë të drejtë me ligj. Vlen të përmendet se dispozitat e Ligjit nr. 04/L-033 u ndryshuan më 29 mars 2014 për të zbatuar kërkesat e nenit 5 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 13 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, të cilat të dyja këto parashohin që gjuha shqipe dhe serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë, që përdoren në të gjitha institucionet e saja.

20. Më tej, Paneli thekson se vendimi i marrë nga i vetmi gjyqtari i DhPGjS-së së EULEX-it nuk e ka përfunduar procedurën. Në rastin konkret, pagesa e tarifës apo shpenzimeve të përkthimit nuk janë vënë si kusht paraprak për fillimin e procedurës pranë DhPGjS-së dhe kërkesa në rastin konkret ka rezultuar vetëm se me vonesë. Aktiviteti i gjykatës nuk varet nga pagesa e këtyre shpenzimeve. Prandaj vetë lëndë është proceduar dhe vendimi është në pritje e sipër lidhur me meritat e lëndës së ankueses. Vijon se vendimi për të mos liruar ankuesen nga shpenzimet e procedurës nuk e kanë shkelur të drejtën e saj për të pasur qasje në gjykatë (shih GjEDNj-në, Urbanek kundër Austrisë, nr. 35123/05, par. 55-56, 9 dhjetor 2010).
21. Paneli më tej thekson se baza ligjore për një vendim sa i përket shpenzimeve parashihet në nenin 12 të Ligjit të DhPGjS-së. Një vendim i tillë mund të jetë dhënë në të mirë të të pandehurit, i cili pastaj mund të mos jetë i detyruar t'i bart shpenzimet. Nëse ankuesja është përgjegjëse për shpenzimet, ajo ende ka një mjet juridik, pra opsionin e paraqitjes së ankesës pranë trupit gjykues të DhPGjS-së. Nëse ankuesja urdhërohet që të paguan këto shpenzime dhe pasi të ketë shteruar këto rrugë procedurale, ajo përsëri mund të parashtrij një ankesë të re në Panel nëse ajo konsideron se të drejtat e saj janë shkelur dhe se të gjitha kërkesat përkatëse juridiksionale janë përmbushur për ta angazhuar Panelin përsëri. Pastaj trupi gjykues do të vendos mbi shpenzimet përfundimtare të procedurës, sipas nenit 67 të Ligjit.
22. Në rrethana të tilla ankesa në Panel është e parakohshme.

PËR KËTO ARSYE

Paneli, njëzëri,

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese